

Takime në kuadrin e projektit QUADIC, Erasmus +

Në kuadrin e projektit QUADIC, janë organizuar dy vizita studimore gjatë muajit maj : në Universitetin e Lubljanës (Slloveni), ne Fakultetin bioteknologjik në datat 7-11/06/2022 , i cili i parapriu takimit të zhvilluar në Universitetin Cote d'Azur në Nice (Francë) gjatë periudhes 26/06/22 - 1/07/22. Universiteti "Eqrem Cabej" është partner i konsorciumit të projektit.



Pamje nga takimi në Universitetin e Ljubljanës.

Gjatë ditëve të trajnimit në Slloveni u mbajt takimi i Bordit për Implementimin e Projektit QUADIC si dhe takimi i Komitetit Drejtues, për të parë zhvillimin e deritanishëm të projektit.



Pamje nga takimi në Universitetin Cote d'Azur

Në këto takime katër ditore u trajtuan çështje të tilla si strategjitë e bashkëpunimit ndërkombëtar, projektet ndërkombëtare duke përfshirë hartimin dhe menaxhimin e tyre si dhe gjetjen e partnerëve për mobilitetin akademik dhe kërkimin. Çështje keto që perbejne objektivat e projektit, i cili synon përmirësimi i arsimit të lartë duke ndërtuar dhe rritur kapacitete për bashkëpunim dhe projekte ndërkombëtare në Kosovë dhe Shqipëri. Theksojmë se ndërkombëtarizimi përbën nje nga misionet e rëndesishme te Institucioneve te Arsimit të lartë. Gjithashtu në këto takime, Universitetet partnere Evropiane prezantuan praktikat që ndjekin në forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtarë në aspektin akademik dhe kërkimore, në nxitjen dhe mbështetjen e mobiliteteve të stafit akademik e studentor.